<p>trafikuar, si dhe ne implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit kundër trafikimit me njerëz.</p> <p>6. Qeveria nxjerr akt nënligjor për përbërjen formale, kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Autoritetit Kombëtar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Emërimi i Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz</p> <p>1. Qeveria emëron një Koordinator Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz (në tekstin e mëtejshëm Koordinator/i).</p> <p>2. Koordinatori kryeson Autoritetin Kombëtar. Koordinatori bashkëpunon vazhdimisht me autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, dhe me autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit, më qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar.</p> <p>3. Koordinatori me mbeshtetjen e Sekretariatit për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin e duhur, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të</p>	<p>of trafficking and protection of victims of trafficking, as well as on implementation of the National Strategy and action plan against trafficking in human beings.</p> <p>6. The Government shall enact sub-legal act on formal composition, powers, responsibilities and the manner of functioning of the National Authority.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Appointment of the National Anti-Trafficking Coordinator</p> <p>1. The Government shall appoint a National Anti-Trafficking Coordinator (hereinafter referred to as the Coordinator).</p> <p>2. The Coordinator shall chair the National Authority. The Coordinator shall regularly cooperate with authorities stipulated in Article 6 of this Law, and other law enforcement authorities, for the purpose of preventing and combating trafficking in human beings and protection of victims of trafficking.</p> <p>3. With the support of the Secretariat National Strategies Monitoring and Evaluation Secretariat, which operates under Ministry of Internal Affairs, the Coordinator shall develop, coordinate and monitor the implementation of National Referral Mechanisms to ensure proper</p>	<p>trgovine ljudima, kao i o sprovođenju Nacionalne strategije i akcionog plana protiv trgovine ljudima.</p> <p>6. Vlada donosi podzakonski akt formalnog sastava, ovlašćenja, odgovornosti i funkcionisanja Državnog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Imenovanje Nacionalnog Koordinatora za Borbu Protiv Trgovine Ljudima</p> <p>1. Vlada imenuje jednog Nacionalnog koordinatora za borbu protiv trgovine ljudima (u daljem tekstu Koordinator).</p> <p>2. Koordinator predseava Državnim organom. Koordinator stalno saraduje sa nadležnim organima iz člana 6 ovog zakona, kao i drugih organa za sprovođenje zakona, u cilju sprečavanja i borbe protiv trgovine ljudima i zaštiti žrtava trgovine ljudima.</p> <p>3. Uz pomoć Sekretarijata za nadgledanje i ocenjivanje nacionalne strategije, koja operiše u okviru Ministarstva Unutrašnjih Poslova, Koordinator razvija, koordinira i prati realizaciju nacionalnog mehanizma upućivanja kako bi se osigurala pravilna identifikacija, upućivanje, pomoć i zaštita žrtava trgovine ljudima, uključujući i</p>
---	--	---

<p>trafikimit me njerëz, përfshirë viktimat fëmijë, dhe për të siguruar se ata pranojnë ndihmën adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.</p> <p>4. Qeveria siguron burime të mjaftueshme financiare dhe resurse të mjaftueshme njerëzore për Koordinatorin, Autoriteti Kombëtar dhe sekretarinë, për të kryer aktivitetet në vazhdim:</p> <p>4.1. koordinimin e zbatimit të këtij ligji, përfshirë hartimin e udhëzimeve, rregulloreve, e akteve nënligjore të tjera, për t'u miratuar nga Qeveria;</p> <p>4.2. hartimin dhe zbatimin e vazhdueshëm të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit, që përmban një pako gjithëpërfshirëse të masave për parandalim dhe luftimin e trafikimit me njerëz si dhe të koordinojë dhe të monitorojë implementimin e tij;</p> <p>4.3. promovimin e hulumtimeve dhe caktimin e procedurave për të analizuar shkallën, natyrën dhe format e reja si të trafikimit vendor ashtu edhe atë ndërkufitar dhe identifikimin e praktikave më të mira për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe ri-integrimin e viktimave të trafikuar, përfshirë mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave për numrin e viktimave të</p>	<p>identification, referral, assistance and protection of victims of trafficking, including child victims, and to ensure that they receive the adequate assistance by protecting their human rights.</p> <p>4. The Government shall ensure sufficient financial and human resources for the Coordinator, National Authority and Secretariat to carry out the following activities:</p> <p>4.1. Coordinating the implementation of this Law, including drafting of administrative instructions, regulations, and other sub-legal acts to be endorsed by the Government;</p> <p>4.2. Drafting and continuous implementation of the National Strategy and Action Plan, which shall contain a comprehensive package of measures for preventing and combating trafficking in human beings, as well as for coordinating and monitoring its implementation;</p> <p>4.3. Promoting researches and determining procedures to analyze the degree, nature and new forms of both local and cross-border trafficking, as well as identification of best practices for preventing and combating trafficking in human beings and reintegration of victims of trafficking, including collection of information on the number of victims disaggregated</p>	<p>decu kao žrtve, kao i da se obezbedi da oni dobiju adekvatnu pomoć oko zaštite njihovih ljudskih prava.</p> <p>4. Vlada obezbeđuje odgovarajuća finansijska sredstva i odgovarajuće ljudske resurse za Koordinatora i Državnog organa i Sekretarijata da obavljaju sledeće aktivnosti:</p> <p>4.1. Koordinacija sprovođenja ovog zakona, uključujući i nacrt uputstva, pravilnika i drugih podzakonskih aktova, da se odobre od strane Vlade;</p> <p>4.2. Nacrt i kontinuirano sprovođenje Nacionalne strategije i Akcionog plana, koji uključuje sveobuhvatni paket mera za sprečavanje i borbu protiv trgovine ljudima i da koordinira i prati njegovo sprovođenje;</p> <p>4.3. Promocija istraživanja i uspostavljanja procedure za analizu obima, prirode i novih oblika nacionalne trgovine ljudima kao i za prekograničnu trgovinu i identifikovanje najbolje prakse za sprečavanje i borbu protiv trgovine ljudima i reintegraciju žrtava trgovine ljudima, uključujući prikupljanje informacija o broju žrtava razvrstanih</p>
--	---	---

<p>ndara sipas gjinisë si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për të analizuar shkallën, natyrën dhe formën e trafikimit.</p> <p>4.4. lehtësimin e bashkëpunimit mes autoriteteve dhe akterëve të ndryshëm qeveritar dhe mes akterëve qeveritar dhe joqeveritar, përfshirë inspektorët e punës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe palëve të tjera relevante të tregut të punës;</p> <p>4.5. lehtësimin e bashkëpunimit mes vendeve të origjinës, transitit dhe destinimit;</p> <p>4.6. veprimin si pikë qendrore për institucionet kombëtare dhe palëve të tjera shtetërore e jo-shtetërore dhe organeve ndërkombëtare për përpjekjet e Qeverisë kundër trafikimit me njerëz;</p> <p>4.7. sigurimin që masat kundër trafikimit të jenë në harmoni me normat ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që parashihen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera relevante.</p> <p>5. Kordinatori Kombëtar do të veprojë si Raportuesi Kombëtar në mënyrë që të kryejnë vlerësime të trendeve të trafikimit me njerëz dhe të masë rezultatet e</p>	<p>according to gender and other data important to analyze the scale, nature and the form of trafficking.</p> <p>4.4. Facilitating cooperation between authorities and various governmental stakeholders and among governmental and nongovernmental stakeholders, including labour inspectors, Kosovo Chamber of Commerce and other relevant parties of the labour market;</p> <p>4.5. Facilitating cooperation between the countries of origin, transit and destination;</p> <p>4.6. Acting as a focal point for national institutions and other state and non-state parties, as well as international bodies, in regards to Government's efforts against trafficking in human beings;</p> <p>4.7. Ensuring that anti-trafficking measures are in line with existing norms and international human rights standards that are envisaged with the Constitution of the Republic of Kosovo and other relevant laws.</p> <p>5. The National Cordiantor will act as the National Rapporteur in order to carry out assessments of trends in trafficking in</p>	<p>po polu i ostalim podacima bitnim za analizu obima, prirode i oblika trgovine ljudima.</p> <p>4.4. Olakšavanje saradnje između vlasti i raznih vladini aktera i između vladinih i nevladinih aktera, uključujući i inspektore rada, Privredne komore Kosova i drugih relevantnih stranama na tržištu rada;</p> <p>4.5. Olakšava saradnju između zemalja porekla, tranzita i odredišta;</p> <p>4.6. Delujući kao tačka fokusa za nacionalne institucije i drugih državnih i nedržavnih aktera i međunarodnih organa u Vladinim naporima za borbu protiv trgovine ljudima;</p> <p>4.7. Obezbediti da mere protiv trgovine ljudima budu u skladu sa međunarodnim normama i standardima ljudskih prava, kao što je predviđeno u Ustavu Republike Kosova i drugim relevantnim zakonima.</p> <p>5. Nacionalni koordinator ce delovati kao Nacionalni Izvestavac tako da na taj nacin obavlja procenu trendova trgovine ljudima i izmeri rezultatet u delovanje</p>
--	--	---

<p>veprimeve antitrafikim, duke përfshirë mbledhjen e statistikave në bashkëpunim të ngushtë me organizatat relevante të shoqërisë civile, aktive në këtë fushë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me njerëz</p> <p>1. Parandalimi, luftimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikuar me njerëz bëhet nga të gjitha autoritetet përfshirë edhe përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore qeveritare dhe joqeveritare duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>2. Autoritetet bëjnë identifikimin e viktimave të trafikimit me njerëz kur ka bazë të arsyeshme për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit.</p> <p>3. Autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme, si edukimi dhe trajnimi, me qëllim të reduktimit të kërkesës që favorizon të gjitha format e shfrytëzimit lidhur me trafikimin me njerëz.</p> <p>4. Autoritetet, në bashkëpunim me organizatat përkatëse dhe shoqërinë civile ndërmarrin veprimet e përshtatshme, përfshirë internetin, fushatat informuese dhe të sensibilizimit, programe shkencore dhe edukuese, me qëllim të sensibilizimit të</p>	<p>human and measure the results of anti-trafficking actions including the gathering of statistics in close cooperation with relevant civil society organisations active in this field.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Preventing and combating of trafficking in human</p> <p>1. Preventing, combating and protecting of victims of trafficking with human beings is carried out by all the authorities, including representatives of local governmental and non-governmental service providers, based on the respective legislation in force;</p> <p>2. Authorities identify victims of trafficking when there are reasonable-grounds for believing that a certain person is a victim of trafficking;</p> <p>3. Authorities should take necessary measures, such as education and training, with goals to reduce the demand that favors all forms of exploitations related to trafficking in human beings.</p> <p>4. Authorities, in cooperation with the respective organizations and civil society actors take appropriate actions, including the internet, such as information and awareness-raising campaigns, research and education programs, aimed at raising</p>	<p>antitrgovine, uključivsi i prikupljanje statistika u tesnu saradnju sa relevantnim organizacijma civilnog drustva, aktivne u ovoj oblasti.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Sprečavanje i borba protiv trgovine ljudskim bićima</p> <p>1. Sprečavanje i borba protiv trgovine ljudskim bićima i zaštiti žrtava trgovine ljudima vrši se od svih organa, uključujući predstavnike lokalnih vladinih i ne-vladinih pružaoca usluga, na osnovu relevantnih zakona koji su na snazi.</p> <p>2. Vlastii identifikuju žrtve trgovine ljudima kada postoje opravdani razlozi da se veruje da je određena osoba žrtva trgovine ljudima.</p> <p>3. Vlasti treba da preduzmu neophodne mere, kao što su obrazovanje i obuka, u cilju smanjivanja potražnje koja favorizuje sve oblike eksploatacije koji se odnose na trgovinu ljudima.</p> <p>4. Vlasti, u saradnji sa relevantnim organizacijama i civilnim društvom preduzimaju odgovarajuće mere, uključujući i internet, informacione kampanje i senzibilizacije, naučnih i obrazovnih programa u cilju</p>
---	--	--

<p>opinionit për trafikimin me njerëz dhe reduktimit të rrezikut që personat e ndryshëm, veçanërisht fëmijët, dhe viktimat e ndjeshme të jenë viktimat të trafikimit.</p> <p>5. Autoritetet do të favorizojnë trajnimet e rregullta të zyrtarëve të cilët mund të jenë në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit, përfshirë zyrtarët e policisë, rojat kufitare, zyrtarët e imigrimit, prokurorët publikë, avokatët, anëtarët e gjyqësorit dhe zyrtarët e gjykatës, inspektorët e punës, personeli i kujdesit social, të fëmijëve dhe atij shëndetësor dhe stafi konsullor, por varësisht nga rrethanat vendore, mund të përfshijë edhe grupet tjera të zyrtarëve publikë, të cilët kanë gjasë që gjatë punës së tyre të hasin në viktimat të trafikimit, me qëllim që të mundësohet identifikimi, referimi dhe trajtimi i dinjitetshëm i viktimave të trafikimit me njerëz.</p> <p>6. Me qëllim të dekurajimit të kërkesës, dhe rritjes së efikasitetit të parandalimit dhe të luftimit të trafikimit të njerëzve, autoritetet do të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim që përdorimi i shërbimeve që janë objekt shfrytëzimi të konsiderohen shkelje penale siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.</p>	<p>awareness about trafficking in human beings and reducing the risk that different persons, especially children, and vulnerable groups becoming victims of trafficking in human beings.</p> <p>5. Authorities will promote regular training for officials who might come in contact with victims or potential victims of trafficking in human beings, including front-line police officers, border guards, immigration officials, public prosecutors, judiciary members and court officials, labor inspectors, social care personnel of children and health and consular staff, but depending on local circumstances, might also include other groups of public officials, who over the course of their work come across victims of trafficking with aim to enable them identification, referral and dignified treatment of trafficking in human beings.</p> <p>6. Aiming at discouraging the demand, increase the efficiency of preventing and combating trafficking in human beings, authorities shall take necessary actions ensuring the utilization of services that are subject of exploitation are considered criminal offences in accordance with Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p>	<p>senzibilizacije javnosti o trgovini ljudima, kao i smanjenje rizika od različitih lica, posebno dece i ugroženih žrtvava da postanu žrtve trgovine ljudima</p> <p>5. Vlasti će favorizovati redovnu obuku službenika koji mogu biti u kontaktu sa žrtvama ili potencijalnim žrtvama trgovine ljudima, uključujući i službenike policije na terenu, graničare, službenike imigracione službe, javne tužioce, članove sudova i sudskih službenika, inspektore rada, osoblje socijalne pomoći za decu i zdravstveni i konzulatni radnici, ali u zavisnosti od lokalnih uslova, mogu takođe uključiti i ostale javne službenike, koji će tokom svog rada nailaziti na žrtve trgovine ljudima sa ciljem da im se omogući identifikacija, upućivanje i dostojanstven tretman žrtava trgovine ljudima</p> <p>6. U cilju obeshrabrivanja potražnje, povećati efikasnost sprečavanja i borbe protiv trgovine ljudima, vlasti moraju da preuzmu neophodne mere kojima se obezbeđuje korišćenje usluga koje su predmet eksploatacije se smatraju krivičnim delima kako je utvrđeno Krivičnim Zakonikom Republike Kosova.</p>
---	---	--

KAPITULLI – III	CHAPTER – III	GLAVA – III
<p data-bbox="226 228 726 256" style="text-align: center;">HETIMI DHE NDJEKJA PENALE</p> <p data-bbox="210 337 743 443" style="text-align: center;">Neni 10 Veprat që ndërlidhen me trafikimin me njerëz dhe bashkimi i procedurës</p> <p data-bbox="191 521 762 699">1. Në rastet kur një veprë penale përmban ndonjë nga elementet e veprës së trafikimit me njerëz nga nenin 5 i këtij ligji, vepra e tillë do të konsiderohet si veprë që ndërlidhet me trafikimin me njerëz.</p> <p data-bbox="191 776 762 922">2. Viktimat e veprave penale nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen viktimat të trafikimit dhe si të tilla i gëzojnë të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj.</p> <p data-bbox="191 959 762 1247">3. Nëse kryesi gjatë procesit të trafikimit me njerëz, me veprimet e veta kryen njëkohësisht edhe vepra penale të tjera që ndërlidhen me veprën e trafikimit, i njëjti do të gjykohet për bashkim të veprave penale në pajtim me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.</p> <p data-bbox="191 1325 762 1468">4. Me qëllim të ruajtjes së rrjedhës dhe tërësisë së procesit, për veprën e trafikimit me njerëz dhe të gjitha veprat që ndërlidhen me veprën e trafikimit, çdo herë kur provat</p>	<p data-bbox="890 228 1230 293" style="text-align: center;">INVESTIGATION AND PROSECUTION</p> <p data-bbox="840 337 1281 480" style="text-align: center;">Article 10 Offenses related to trafficking in human beings and joinder of proceedings</p> <p data-bbox="789 521 1339 735">1. In cases when criminal action contains one of the elements of the offense of trafficking in human beings from the Article 5 of this Law, such an offense shall be considered as an offense that is related to trafficking in human beings.</p> <p data-bbox="789 776 1339 922">2. Victims of the offences from the Paragraph 1 of this Article are considered victims of trafficking and as such they enjoy all the rights envisaged by this Law.</p> <p data-bbox="789 959 1339 1284">3. If the perpetrator, during the process of trafficking in human beings, with his/her actions simultaneously commits other offenses related to the offense of trafficking, he/she will be judged in association of the offenses in line with the provisions of the Criminal Code and Criminal Procedure Code of the Republic of Kosovo.</p> <p data-bbox="789 1325 1339 1468">4. Aiming to preserve the course and integrity of the process for the offense of trafficking in human beings and all the actions related to the offense of</p>	<p data-bbox="1367 228 1885 256" style="text-align: center;">ISTRAGA I KRIVIČNO GONJENJE</p> <p data-bbox="1360 337 1892 443" style="text-align: center;">Član 10 Prekršaji koji se povezuju sa trgovinom ljudima i spajanje postupka</p> <p data-bbox="1360 521 1892 699">1. U slučajevima kada krivično delo uključuje i neki od elemenata krivičnog dela trgovine ljudima iz člana 5 ovog zakona, takva dela smatraju se delima povezanim sa trgovinom ljudima.</p> <p data-bbox="1360 776 1892 922">2. Žrtve krivičnih dela iz stava 1. ovog člana smatraju se za žrtve trgovine ljudima i kao takvi uživaju sva prava predviđena ovim zakonom.</p> <p data-bbox="1360 959 1892 1214">3. Ukoliko počinitelj za vreme procesa trgovine ljudima, sa svojim radnjama u isto vreme čini i druga krivična dela povezanim sa trgovinom ljudima, isti će se suditi za spajanje krivičnih dela i biće kažnjeni u skladu sa odredbama Krivičnog zakonika Republike Kosova.</p> <p data-bbox="1360 1325 1892 1468">4. U cilju održavanja toka i celokupnosti procesa, za krivično delo trgovine ljudima i svih radnji vezanih za trgovinu ljudima, svaki put kada su dela povezana,</p>

<p>janë të përbashkëta, do të zhvillohet procedurë e përbashkët në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.</p> <p>5. Kur për shkak të ruajtjes së efikasitetit apo shkaqeve të tjera të rëndësishme, nuk është e mundur bashkimi i procedurës sipas paragrafit 4 të këtij neni, çështjet do të procedohen ndaras në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.</p> <p>6. Çështjet rreth bashkimit apo veçimit të procedurës, si dhe çështjet rreth kompetencës (juridiksionit) së gjykatës për veprat sipas këtij ligji rregullohen në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.</p>	<p>trafficking, every time that evidences are associated, a joined proceeding will take place, in line with the provisions of the Criminal Procedure Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>5. In cases when for the sake of preserving the efficiency or other relevant reasons, if it is not possible to associate the procedure according to Paragraph 4 of this Article, cases will be proceeded separately, in line with the provisions of the Criminal Procedure Code of Kosovo.</p> <p>6. Issues regarding association or separation of the procedure, as well issues related to competence (jurisdiction) of the court for the acts according to this Law are settled in line with the Criminal Procedure Code.</p>	<p>obaviće se ujedineni sudski postupak Krivičnog zakonika Republike Kosova</p> <p>5. Kada zbog efikasnosti skladištenja ili drugih važnih razloga, nije moguće ujedinenje postupka, u skladu sa stavom 4 ovog člana, postupci će biti posebno obrađeni Krivičnog zakonika Republike Kosova</p> <p>6. Pitanja o pripajanju ili razdvajanje postupka, kao i pitanja oko nadležnosti (jurisdikcije) suda za krivična dela po ovom zakonu su regulisana u skladu sa Zakonom o krivičnom postupku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Hetimi dhe ndjekja</p> <p>1. Kur është e nevojshme, mjetet hetimore të parapara në Kodin e Procedurës Penale, si ato që përdoren për krimin e organizuar apo veprat tjera të rënda penale, i vihen në dispozicion autoriteteve të zbatimit të ligjit për hetimin apo ndjekjen e veprave të trafikimit me njerëz dhe veprave tjera që përmbajnë elemente të veprës së trafikimit.</p> <p>2. Me qëllim që hetimit dhe ndjekjes penale</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Investigation and prosecution</p> <p>1. When necessary, investigation means envisaged by the Criminal Code Procedure, such as the ones used for organized crime or other grave offenses are put at disposal of law enforcement authorities for investigation or prosecution of offenses of trafficking in human beings and other offenses that contain elements of the offense of trafficking.</p> <p>2. In order to have an effective</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Istraga i gonjenje</p> <p>1. Kada je potrebno, istražne radnje predviđene u Zakonu o krivičnom postupku, kao one koje se koriste za organizovani kriminal ili druga teška krivična dela, dostupna su organima za sprovođenje zakona u istrazi ili krivičnom gonjenju kod dela trgovine ljudima i ostale radnje koje sadrže elemente krivičnog dela trgovine ljudima.</p> <p>2. U cilju efikasne istrage i krivičnog</p>

<p>efektive të rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë, Prokuroria e Shtetit dhe Policia, krijojnë ekipe të përbashkëta hetimore.</p> <p>3. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët identifikojnë dhe bëjnë ngrirjen, sekuestrimin apo konfiskimin e mjeteve të përdorura dhe dobisë pasurore të fituar nga vepra e trafikimit me njerëz dhe çfarëdo pasurie tjetër të paligjshme siç përcaktohet në Kapitullin VII të Kodit Penal.</p> <p>4 Ndjekja dhe hetimi i veprave kundër trafikimit me njerëz nuk varet nga raportimi apo akuza e një viktime të trafikuar, dhe procedura penale mund të vazhdojë edhe nëse viktima e trafikuar e tërheq qëndrimin e tij/saj,</p> <p>5. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale u njohin viktimave të trafikimit me njerëz masat për garantimin e të drejtave dhe sigurisë së tyre fizike, ashtu siç përcaktohet me Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Mbrojtjen Dëshmitarëve dhe legjislacioni tjetër përkatës në Kosovë.</p> <p>6. Autoritetet organizojnë trajnime të duhura për personat, njësitë apo shërbimet përgjegjëse të cilët/at merren me hetimin ose ndjekjen penale të veprave të trafikimit me njerëz.</p>	<p>investigation and prosecution of cases of trafficking in human beings in Kosovo, State Prosecution and Police can bring together joint investigative teams.</p> <p>3. Law enforcement authorities and prosecutors identify and freeze, seize or confiscate assets used and wealth gained from the offense of trafficking in human beings, and any other illegal asset in line with Chapter VII of the Criminal Code.</p> <p>4. Prosecution and investigation of offenses against trafficking in human beings does not depend on the reporting or accusations of a victim of trafficking, and the criminal procedure can continue even if the victim of trafficking withdraws his/her statement.</p> <p>5. Courts and bodies for criminal prosecution recognize the measures for ensuring the rights and their physical safety to victims of trafficking in human beings, as set with the Criminal Procedure Code and the Law on Witness Protection, as well as other respective legislation in Kosovo.</p> <p>6. Authorities organize adequate trainings for persons, units or services in charge that deal with investigation or criminal prosecution of actions of trafficking in human beings.</p>	<p>gonjenja sluchajeva trgovine ljudima na Kosovu, Džavno Tužilaštvo i Policija stvaraju zajedničke istražne timove.</p> <p>3. Organi sprovođenja zakona i tužioci identifikuju i zamrzavaju, konfiskuju ili oduzimaju upotrebljena sredstava i materijalne koristi stečene od krivične radnje trgovine ljudima i bilo koje druge ilegalne imovine. Kao je utvrđeno u Poglavlju VII Krivičnog Zakonika</p> <p>4. Tužilaštvo i istraga za krivična dela protiv trgovine ljudima ne zavise od izveštaja ili optužbi žrtve trgovine ljudima, a krivični postupak može da se nastavi čak i ako je žrtva trgovine ljudima povuče njegovu / njenu izjavu.</p> <p>5. Sudovi i organi krivičnog gonjenja priznaju mere za obezbeđivanje prava i njihovu fizičku bezbednost za žrtve trgovine ljudima, kao i set sa Zakonikom o krivičnom postupku i Zakon o zaštiti svedoka, kao i drugim odgovarajućim zakonima na Kosovu.</p> <p>6. Vlasti organizuju odgovarajuću obuku za lica, jedinice ili odgovornih službi koje učestvuju u istrazi ili krivičnom gonjenju dela trgovine ljudima.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 12 Identifikimi zyrtar i viktimave të trafikuar</p>	<p align="center">Article 12 Official identification of victims of trafficking</p>	<p align="center">Član 12 Zvanična identifikacija ųrtava trgovine ljudima</p>
<p>1. Identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz e bëjnë njësitë përkatëse të policisë, prokurorisë, mbrojtësi i viktimave dhe qendrat për punë sociale bazuar në nenin 5 të këtij ligji, kur kanë dyshim të bazuar për të besuar se një person i caktuar është viktimë e trafikimit në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit të hartuara nga autoritetet përkatëse.</p> <p>2. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me autoritetet përkatëse hartojnë listën e treguesve lidhur me trafikimin e me njerëz, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të viktimave nga autoritetet policore, penale, gjyqësore dhe sociale të cilët mund të jenë në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme. Lista e treguesve miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Qeveria me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës dhe e Mirëqenies Sociale, nxjerr udhëzues specifik për shërbimet konsullore, policinë kufitare dhe inspektorët e punës me qëllim të identifikimit të hershëm të viktimave të trafikimit.</p>	<p>1. Official identification of victims of trafficking in human beings is done by the respective Police units, Prosecution, Victim Advocate and centers for social work based on Article 5 of this Law, when they have grounded doubt for believing that a certain person is a victim of trafficking, in line with the Standard Operating Procedures developed by the respective authorities.</p> <p>2. Ministry of Justice in cooperation with respective authorities draft the indicators' list regarding trafficking in human beings, with aim to facilitate identification of victims by police, criminal, judicial and social authorities that might be in contact with the victims or potential victims of trafficking. Indicators' list is adopted by the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Upon proposal of the Ministry of Internal Affairs, the Ministry of Foreign Affairs and the Ministry of Labour and Social Welfare issue specific instructions for consular services, border police and labour inspectors with the aim of early identification of victims of trafficking.</p>	<p>1. Zvaničnu identifikaciju ųrtava trgovine ljudima vrše odgovarajuće policijske jedinice, tuųilaštva, advokata ųrtve i centri za socijalni rad, u skladu sa članom 5 ovog zakona, kada oni imaju opravdanu sumnju da veruje daje određena osoba ųrtva trgovine ljudima. U skladu sa Standardnim Procedurama Delovanja izrađene od strane doticnih vlasti.</p> <p>2. Ministarstvo pravde u saradnji sa nadležnim organima sastavlja spisak smernica u vezi sa trgovinom ljudima, kako bi se olakšala identifikacija ųrtava koje autoriteti policije, pravosudnih i socijalnih usluga koji mogu doći u kontakt sa ųrtvama ili potencijalnim ųrtvama. Lista indikatora usvaja se od strane Vlade Republike Kosova.</p> <p>3. Vlada na predlog Ministarstva unutrašnjih poslova, Ministarstva spoljnih poslova i Ministarstva rada i socijalne zaštite izdaje posebna uputstva za konzularne usluge, granične policije i inspektore rada u cilju rane identifikacije ųrtava trgovine ljudima.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 13 Përrjashtimi i përgjegjësisë së viktimave të trafikimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Non-liability of victims of trafficking</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Isključenje odgovornosti ųrtava trgovine ljudima</p>
<p>1. Viktimat e trafikimit nuk duhet të arrestohen dhe nuk mund të ndiqen penalisht për vepra penale dhe kundërvajtje, të kryera nga ai /ajo/si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës së trafikimit me njerëz, përfshirë:</p> <p>1.1. hyrjen dhe daljen e paligjshme të personit të trafikuar, në/nga shteti;</p> <p>1.2. blerjen apo posedimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit apo identifikimit të cilat ai i ka marrë, apo të cilat iu janë dhënë atij, me qëllim të hyrjes apo daljes nga shteti në lidhje me veprën penale të trafikimit me njerëz;</p> <p>1.3. përfshirjen e viktimës në veprimtari tjera të paligjshme deri në atë masë që kjo përfshirje është pasojë direkte e situatës së tyre të trafikimit;</p> <p>2. Fëmijët të cilët janë viktimat të trafikimit nuk i nënshtrohen procedurave apo sanksioneve penale për veprat penale që ndërliohen me situatën e tyre si viktimat të trafikuar.</p>	<p>1. A victim of trafficking should not be arrested and cannot be criminally prosecuted for criminal and minor offences committed by him/her as a direct result of the crime of trafficking in human beings, including:</p> <p>1.1. Illegal exit and entry of the trafficked person from/out the country</p> <p>1.2. Purchase or possession of false travel or identification documents that he/she took, or he/she was given, for the purpose of entering or exiting the country regarding the criminal act of trafficking in human beings;</p> <p>1.3. Involvement of the victim in unlawful activities to the extent that such involvement is a direct consequence of their situation as trafficked persons;</p> <p>2. Children that are victims of trafficking are not subject to procedures or legal sanctions for offenses related to their situation as victims of trafficking.</p>	<p>1. ųrtve trgovine ljudima ne mogu biti uhapšene i ne mogu biti gonjene za zločine i krivična dela i prekršaje počinjene od njega/nje kao direktne posledice krivičnog dela trgovine ljudima, uključujući:</p> <p>1.1. Ilegalni ulazak i izlazak u države ųrtva trgovine ljudima;</p> <p>1.2. Kupovina ili posedovanje lažnih putnih ili identifikacionih dokumenata koje je uzela, ili koja je data njoj/njemu u cilju ulaska ili izlaska iz zemlje u vezi sa krivičnim delom trgovine ljudima;</p> <p>1.3. uključivanje ųrtve u ostala delovanja do te mere da ovo uključenje je kao direktna posledica njihove situacije trgovine;</p> <p>2. Deca koja su ųrtve trgovine ljudima ne podležu krivičnom postupku ili kazni za prekršaje koji se odnose na njihovu povezanu situaciju kao ųrtve trgovine ljudim.</p>

<p align="center">Neni 14 Përgjegjësia e personave juridik</p>	<p align="center">Article 14 Liability of legal persons</p>	<p align="center">Član 14 Odgovornost pravnih lica</p>
<p>1. Personat juridik mbahen përgjegjës për veprat e trafikimit me njerëz, të kryera për përfitim të tyre nga një person, i cili vepron qoftë individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, e që ka një pozitë udhëheqëse në kuadër të personit juridik, duke u mbështetur në:</p> <p>1.1. kompetencën për ta përfaqësuar personin juridik;</p> <p>1.2. autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik.</p> <p>1.3. autoritetin për të ushtruar kontroll përbrenda personit juridik.</p> <p>2. Personat juridik mbahen përgjegjës edhe në rastin kur mungesa e mbikëqyrjes apo kontrollit nga një person i cekur në paragrafin 1 të këtij neni ka bërë të mundur kryerjen e veprës së trafikimit me njerëz, për përfitime të atij personi juridik, nga ana e një personi nën autoritetin e tij.</p> <p>3. Përgjegjësia e një personi juridik sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, nuk do ta përjashtoj zhvillimin e procedurës penale kundër personave fizik, që janë kryes, nxitjes ose ndihmës në veprat e trafikimit me njerëz.</p>	<p>1. Legal persons are kept liable for offenses of trafficking in human beings, committed for their gain by one person, who acts either individually or as part of a body of the legal person, and who has a leading position under the legal person, based on the:</p> <p>1.1. Competence to represent the legal person;</p> <p>1.2. Authority to take decisions on behalf of the legal person;</p> <p>1.3. Authority to exercise control within the legal person.</p> <p>2. Legal persons are also held liable in the case when the lack of oversight or control by a person mentioned on paragraph 1 of this Article has made the act of trafficking in human beings possible, for benefit of that legal person by the part of a person under his/her authority.</p> <p>3. According to paragraph 1 and 2 of this Article, liability of a legal person shall not prevent criminal proceedings against natural persons, who committed, incited or aided the trafficking in human beings.</p>	<p>1. Pravna lica su odgovorna za dela trgovine ljudima, izvršena za njihovu korist od jednog lica, koje postupa bilo individualno ili kao deo nekog organa pravnog lica, koji ima vodeću poziciju u pravnom licu, zasnivajući se na se na:</p> <p>1.1. nadležnosti da zastupa pravno lice;</p> <p>1.2. ovlašćenja da donosi odluke u ime pravnog lica.</p> <p>1.3. ovlašćenja da vrši kontrolu unutar pravnog lica.</p> <p>2. Pravna lica su odgovorna i u slučaju nedostatka nadzora ili kontrole od strane lica pomenutih u stavu 1 ovog člana koji je omogućio izvršenje krivičnog dela trgovine ljudima u korist tog pravnog lica, od strane lica u njegovoj nadležnosti.</p> <p>3. Odgovornost pravnog lica iz stava 1. i 2. ovog člana ne isključuje vođenje krivičnog postupka protiv fizičkih lica koji su počinioci, ohrabruju ili pomažu u trgovini ljudima.</p>

<p>4. Sanksionet penale kundër personave juridik për rastet e trafikimit me njerëz do të zbatohen sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Trajtimi i viktimave të trafikimit me njerëz gjatë hetimit dhe procedurës penale</p> <p>1. Viktimat e trafikimit me njerëz e pranojnë mbrojtjen e duhur në bazë të vlerësimit individual të rrezikut.</p> <p>2. Në rastet kur para gjykatës shqyrtohen çështjet lidhur me veprat sipas këtij ligji, për persona të identifikuar si viktimë, prokurori dhe palet e tjera të autorizuar duhet të kërkojnë dhe gjykata lejojnë aplikimin e mundësisë hetuese të veçantë, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Deklaratat do të incizohen dhe do të jenë plotësisht të pranueshme gjatë gjykimit. Deklaratat nga ky paragraf mund të përdoret për viktimat vendore dhe viktimat të cilat gjenden jashtë Kosovës.</p> <p>3. Pa paragjykim ndaj të drejtave të mbrojtjes, dhe në pajtim me vlerësimin individual të bërë nga autoritetet, viktimat pranojnë trajtim specifik që synon parandalimin e viktimizimit të sërishëm posacerisht viktimat e ndjeshme duke shmangur, për aq sa është e mundshme</p>	<p>4. Legal sanctions against legal persons on cases of trafficking in human beings will be applied in accordance with the Law on liability of legal persons' actions for offenses.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Treatment of victims of trafficking in human beings in criminal investigation and proceedings</p> <p>1. Victims of trafficking in human beings receive adequate protection based on the individual risk assessment.</p> <p>2. In cases when issues related to offenses according to this Law are reviewed in the court, for persons identified as victims, the prosecutor and other authorized parties must request and the court allows application of the special investigation opportunity, in line with the Criminal Procedure Code. Statements will be recorded and they will be completely acceptable during the trial. Statements from this paragraph might be used for local victims and victims that are located outside of Kosovo.</p> <p>3. Without prejudice to the rights to protection, and in accordance with individual assessment carried out by the authorities, victims receive special treatment that aims to prevent re-victimization, in particular for vulnerable victims, thus avoiding, for as much as it is</p>	<p>4. Krivične sankcije protiv pravnih lica za trgovinu ljudima će biti sprovedene u skladu sa Zakonom o odgovornosti pravnih lica za krivična dela.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Tretman žrtava trgovine ljudima tokom istrage i krivičnog postupka</p> <p>1. Žrtve trgovine ljudima dobiju odgovarajuću zaštitu na osnovu individualne procene rizika.</p> <p>2. U slučajevima kada se pred sud razmatraju pitanja koja se odnose na dela po ovom zakonu, za osobe identifikovane kao žrtve, tužilac može zahtevati i sud će omogućiti primenu specijalnih istražnih prilika, u skladu sa Zakonom o krivičnom postupku. Izjave će biti zabeležene i biće potpuno prihvatljive na suđenju. Izjave u ovom stavu mogu se koristiti za lokalne žrtve i žrtve koji su van Kosova.</p> <p>3. Bez prejudiciranja prava na odbranu, a u skladu sa individualnom procenom od strane autoriteta, žrtve dobiju poseban tretman u cilju sprečavanja ponovne viktimizacije, izbegavajući, koliko je to moguće sledeće situacije:</p>
--	---	---

<p>situatat si në vijim:</p> <p>3.1. përsëritjen e panevojshme të intervistave gjatë hetimit, ndjekjes apo gjykimit;</p> <p>3.2. kontaktin (ballafaqim) vizual ndërmjet viktimave dhe të pandehurve, gjatë dhënies së dëshmisë si intervistat dhe marrjet e tërthorta në pyetje, përmes mjeteve të duhura përfshirë përdorimin e teknologjive të përshtatshme të komunikimit;</p> <p>3.3. dhënien e dëshmisë në seancë të hapur për publikun; dhe</p> <p>3.4. marrjen e panevojshme në pyetje lidhur me marrëdhëniet intime të viktimës gjatë kohës sa ai/ajo ka qenë e trafikuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Trajtimi i viktimave fëmijë të trafikimit me njerëz gjatë hetimeve dhe procedurave penale</p> <p>1. Pa paragjykim ndaj të drejtave të mbrojtjes, dhe në pajtim me vlerësimin individual të bërë nga autoritetet, viktimat fëmijë pranojnë trajtim të veçantë që synon parandalimin e viktimizimit të sërishëm duke shmangur, për aq sa është e mundur, situatat si në vijim:</p> <p>1.1. intervistat me viktimat fëmijë të</p>	<p>possible, the following situations:</p> <p>3.1. Unnecessary repetition of interviews during investigation, criminal prosecution or trial;</p> <p>3.2. Visual contact (confrontation) between the victims and defendants while giving testimony such as interviews and indirect interrogations, through adequate means including appropriate communication technologies;</p> <p>3.3. Giving testimony in open public session, and</p> <p>3.4. Unnecessary interviewing regarding intimate relations of the victim while he/she was trafficked.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Treatment of child victims of trafficking in human beings in criminal investigation and proceedings</p> <p>1. Without prejudice to the rights to protection, and in accordance with individual assessment carried out by the authorities, child victims receive special treatment that aims to prevent re-victimization, thus avoiding, for as much as it is possible, the following situations:</p> <p>1.1. Interviews with the child victims</p>	<p>3.1. nepotrebna ponavljanja intervjuja tokom istrage, krivičnog gonjenja ili suđenja;</p> <p>3.2. vizuelni kontakt (suočavanje) između žrtava i optuženih, dajući iskaz kroz intervjuje i indirektnih pitanja, putem odgovarajućih sredstava, uključujući korišćenje odgovarajućih komunikacionih tehnologija;</p> <p>3.3. svedočenje na otvorenon saslušanju za javnost; i</p> <p>3.4. nepotrebno ispitivanje o intimnim odnosima dok je žrtva bio/la trgovana.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Tretman dece žrtava trgovine ljudima tokom istrage i krivičnog postupka</p> <p>1. Bez prejudiciranja prava na odbranu, a u skladu sa individualnom procenom od strane vlasti, deca žrtve dobiju poseban tretman u cilju sprečavanja ponovne viktimizacije, izbegavajući, koliko je to moguće sledeće situacije:</p> <p>1.1. Intervjui sa decom žrtvama treba</p>
--	---	---

<p>bëhen pa vonesë të paarsyeshme pas raportimit të fakteve tek autoritetet kompetente;</p> <p>1.2. intervistat me viktimat fëmijë të bëhen, në ndërtesa të dizajnuara dhe përshtatura për atë qëllim;</p> <p>1.3. intervistat me viktimat fëmijë të bëhen çdo herë nga apo përmes profesionistëve të trajnuar për atë qëllim;</p> <p>1.4. nëse është e mundur, zyrtarët e njëjtë kryejnë të gjitha intervistat me viktimën fëmijë;</p> <p>1.5. intervistimi i viktimës fëmijës behet vetëm një herë. Numri i intervistave mund të jetë me shumë se një vetëm për qëllime të hetimeve të veçanta dhe të komplikuar , në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale;</p> <p>1.6. Viktima fëmijë shoqërohet nga një përfaqësues i autorizuar, ose kur është e përshtatshme, nga një i rritur sipas zgjedhjes së fëmijëve, përveç rasteve kur është marrë vendim i arsyetuar që e kundërshton zgjedhjen e atij personi.</p>	<p>shall take place without unjustifiable delay after the facts have been reported to the competent authorities;</p> <p>1.2. Interviews with child victims take place, in premises designed or adapted for that purpose;</p> <p>1.3. Interviews with child victims are carried out, using child appropriate interviewing techniques by or through professionals trained for that purpose ;</p> <p>1.4. If possible, the same officers conduct all interviews with the child victim;</p> <p>1.5. The number of interviews of the child victim is limited to one. The number of interviews can be more than one only for the purposes of exceptional and complex investigations. in line with the Justice Code for Minors, Criminal Code and Criminal Procedure Code of Republic of Kosovo.</p> <p>1.6. The victim child may be accompanied by an authorized representative, or when appropriate, an adult according to his/her choice, unless a reasoned decision has been made to the contrary in respect of that person.</p>	<p>da se vrše bez nepotrebnih odlaganja nakon prijavljivanja činjenice nadležnim organima;</p> <p>1.2. Intervjui sa decom žrtvama treba da se vrše, u dobro dizajniranim zgradama i prilagođenim za tu svrhu;</p> <p>1.3. Intervjui sa decom žrtvama treba da se vrše, od strane ili putem profesionalaca obučениh za tu svrhu;</p> <p>1.4. Ako je moguće i kad je prikladano, isti zvaničnici će sprovoditi sve intervjuje sa detetom žrtvom;</p> <p>1.5. . intervjuisanje zrtve dete se vrši samo jednom. Broj intervjuja može biti više od jednog puta sa ciljem posebnih i složenih istraga, u skladu sa zakonikom Pravde za maloletnike, Krivični Zakonik i Zakon e Krivičnoj Proceduri;</p> <p>1.6. Deca žrtve se prate se od strane jednog ovlašćenog zastupnika ili, kad je to prikladno, od jedne odrasle osobe po izboru deteta, osim u slučajevima kad je doneta obrazložena odluka o protivrečnosti izbora osobe.</p>
--	---	---

<p>2. Dispozitat nga neni 15, paragrafi 2, do të aplikohen <i>mutatis mutandis</i> (përshtatshmërisht) gjatë marrjes së deklaratës së fëmijëve viktima.</p> <p>3. Gjykata ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që në procedurat që ndërlidhen me cilëndo nga veprat e trafikimit me njerëz, kur një fëmijë viktimë është i përfshirë, mund të urdhëroj që:</p> <p>3.1. seanca të mbahet pa praninë e publikut; dhe</p> <p>3.2. viktima fëmijë të dëgjohet në gjykatë pa qenë e pranishme, veçanërisht, përmes përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Mbyllja e objekteve dhe bizneseve afariste që janë të përfshira dhe e mundësojnë trafikimin me njerëz</p> <p>Në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se një objekt apo biznes afarist, që vepron në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, është i përfshirë, në çështjet e trafikimit me njerëz, sipas këtij ligji dhe Kodit të Procedurës Penale prokurori i kërkon gjyqtarit mbylljen e menjëhershme të atij objekti apo biznesi afarist.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Mbrojtja e të dhënave /Personale dhe</p>	<p>2. Provisions from Article 14, paragraph 2, shall be applied <i>mutatis mutandis</i> while taking the statement of child victims.</p> <p>3. Court – takes necessary measures to ensure that in criminal court proceedings of any of the offences of trafficking in human beings, when a child victim is involved, it might order that:</p> <p>3.1. Hearing is held without the presence of the public, and</p> <p>3.2. Child victim is heard in courtroom without being present, in particular, through use of appropriate communication technologies.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Closing of premises or businesses involved or facilitating trafficking in human beings</p> <p>In cases when there is grounded suspicion that a premise or business, acting legally or illegally, is involved in issues of trafficking in human beings, according to this Law and Criminal Procedure Code, the prosecutor demands from the judge immediate closure of the premises or the business.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Protection of data/personal and privacy</p>	<p>2. Odredbe člana 14, stava 2, primenjuju se <i>mutatis mutandis</i> (adekvatno) tokom prijema izjave dece žrtava.</p> <p>3. Sud- preduzima neophodne mere u cilju obezbeđivanja da procedure koje se odnose na bilo koje od krivičnih dela trgovine ljudima, kada je dete žrtva uključeno, može narediti da:</p> <p>3.1. Ročište će se održati bez prisustva javnosti; i</p> <p>3.2. Deca žrtve da budu saslušane u sudu, u odsustvu, naročito kroz korišćenje odgovarajućih prikladnih komunikacionih tehnologija.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Zatvaranje objekata i komercijalnih firmi koje su uključene i omogućavaju trgovinu ljudima</p> <p>U slučajevima gde postoji osnovana sumnja da poslovni objekat ili komercijalni biznis, koji deluje zakonito ili nezakonito, je umešan u poslove trgovine ljudima, u skladu sa ovim zakonom, tužilac traži od suda momentalno zatvaranje tog objekta ili komercijalnog biznisa.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Zaštita podataka/lični i privatnost</p>
---	--	---

privatësisë		
<p>1. Të dhënat personale, jeta private dhe identiteti i viktimave të trafikimit me njerëz mbrohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit gjatë procedurës penale. Regjistrimi, mirëmbajtja, dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të viktimës së trafikimit bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>	<p>1. Personal data, private life and identity of victims of trafficking are protected by the law enforcement authorities during the criminal procedure. The recording, maintenance, utilization of personal data of the victim of trafficking is carried out in line with conditions set by the Law on Protection of Personal Data.</p>	<p>1. Lični podaci, privatni život i identitet žrtava trgovine ljudima zaštićen je organima za sprovođenje zakona u toku krivičnog postupka. Registracija, održavanje i korišćenje ličnih podataka žrtve trgovine vrši se u skladu sa uslovima propisanim u Krivičnom zakoniku i Zakonu o zaštiti ličnih podataka.</p>
<p>2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të hartohet një marrëveshje për shkëmbimin e informacioneve ndërmjet autoriteteve që merren me identifikimin dhe ndihmën e viktimës, si dhe me hetimin penal duke respektuar në tërësi mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë dhe sigurisë së viktimave.</p>	<p>2. In line with paragraph 1 of this article, an agreement for exchange of information between authorities that deal with identification and assistance of the victim should be drafted, as well as with criminal investigation while fully respecting the protection of personal data and privacy and safety of the victims' integrity.</p>	<p>2. U skladu sa stavom 1 ovog člana treba da bude izrađen sporazum za razmenu informacija između organa koji se bave identifikacijom i pomoći žrtvama, kao i krivične istrage sa punim poštovanjem zaštite ličnih podataka i zaštite privatnosti i bezbednosti žrtava.</p>
<p>3. Të gjitha informacionet e shkëmbyera ndërmjet viktimës dhe profesionistit që ofron shërbime mjekësore, psikologjike, juridike apo ndihmë tjetër janë konfidenciale dhe nuk shkëmbehen me personat e tretë pa pëlqimin e viktimës, e në rastet e viktimës fëmijë pa pëlqimin e përfaqësuesit ligjor.</p>	<p>3. All information exchanged between the victim and a professional providing medical, psychological, legal or other assistance or services shall be confidential and shall not be exchanged with the third persons without victim's consent, in case of a child victim, without the consent of the legal representative.</p>	<p>3. Sve informacije koje se razmenjuju između žrtve i profesionalca koji pruža medicinsku, psihološku, pravnu i drugu pomoć su poverljive i ne dele se sa trećim licima bez saglasnosti žrtve, a u slučajevima dece žrtava bez saglasnosti zakonskog zastupnika.</p>
<p>4. Ndalohet zbulimi i të dhënave që kanë të bëjnë me masat e mbrojtjes shtetërore për viktimat e trafikimit me njerëz, personat të cilët ofrojnë mbrojtjen e tillë, si dhe personat të cilët ofrojnë ndihmë në luftimin e trafikimit me njerëz.</p>	<p>4. Disclosure of data related to state protection measures for the victims of trafficking in human beings, persons that provide such protection, as well as persons that provide assistance in fighting trafficking in human beings is forbidden.</p>	<p>4. Zabranjeno je obelodanjivanje podataka koji se odnose na državne mere zaštite za žrtve trgovine ljudima, lica koja pružaju takvu zaštitu, kao i one koji pružaju pomoć u borbi protiv trgovine ljudima.</p>

<p>5. Në rast se jeta dhe shëndeti i viktimës së trafikimit me njerëz është e kanosur nga rreziku real, atëherë asaj i mundësohet, sipas kërkesës së saj, në bazë të vendimit të gjykatës të nxjerrë sipas kërkesës së prokurorit, mundësia për të ndryshuar emrin e tij/saj, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, në pajtim me kushtet e përcaktuara në me ligjin për mbrojtjen e të dhenave personale dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>6. Zbulimi i informacioneve mbi masat e sigurisë dhe të dhënave konfidenciale të viktimës së trafikimit, si dhe zbulimi i informacionit që ka të bëjë me ndjekjen penale dhe masat e ofruara për sigurinë e pjesëmarrësve në procedurë penale, dënohet në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin për vepra penale dhe administrative.</p>	<p>5. In case that the life or health of the victim of trafficking is threatened from the real danger, than, according to his/her request, based on the court decision taken upon prosecutor's request, he/she is given the possibility to change his/her name, surname, date and place of birth, in line with conditions set in the law for protection of personal data and respective legislation in force.</p> <p>6. Disclosure of information regarding protection measures and confidential information of the victim of trafficking, as well as disclosure of information related to criminal prosecution and measures provided for the safety of participants in criminal procedure, is sentenced in line with the law for the protection of personal data and legislation on criminal and administrative acts.</p>	<p>5. U slučaju da život i zdravlje žrtve trgovine ljudima je ugrožen i realnoj opasnosti, onda je omogućeno, na njegov zahtev, na osnovu sudske odluke izdate na zahtev tužioca, mogućnost da promeni svoje ime i prezime, datum i mesto rođenja, u skladu sa zakonom za zaštitu ličnih podataka i uslovima relevantnog zakonodavstva na snazi.</p> <p>6. Obelodanjivanje informacija o bezbednosnim merama i poverljivih podataka o žrtvi trgovine ljudima, kao i objavljivanje informacija koje se odnose na krivično gonjenje i mera predviđenih za bezbednost učesnika u krivičnom postupku, biće kažnjeno u skladu sa zakonom za zaštitu ličnih podataka i zakonima o krivičnim i administrativnim delima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Sigurimi i viktimave apo dëshmitarëve</p> <p>1. Organi kompetent i përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që viktimës apo dëshmitarit të trafikimit me njerëz, dhe familjes së tij, t'i ofrohet mbrojtje adekuate në rast se siguria e tij është në rrezik, përfshirë masat për mbrojtjen e tij nga frikësimi dhe hakmarrja e trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Ensuring safety of the victims or witnesses</p> <p>1. Competent body as defined in the Law on Protection of Witnesses, takes all necessary measures to ensure that the victim or the witness of trafficking in human beings and his/her family is provided with appropriate protection in case that his/her security is at risk, including measures for his/her protection from intimidation and retaliation of</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Obezbeđenje žrtve ili svedoka</p> <p>1. Nadležni organ Utvrđen zakonom za zastitu Svedokaće preduzeti sve neophodne mere da obezbede da žrtve ili svedoci trgovine ljudima, i njihove porodice, dobiju adekvatnu zaštitu u slučaju da im je bezbednost ugrožena, uključujući mere za zaštitu od zastrašivanja ili osвете trgovaca i</p>

<p>2. Kur është e nevojshme për garantimin e sigurisë fizike të viktimës apo dëshmitarit, në bazë të kërkesës së viktimës apo dëshmitarit apo në konsultim me të, organi kompetent ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zhvendosjen e tij brenda apo jashtë Kosovës në pajtim me nën-kreu H të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufizimin e zbulimit të emrit, adresës dhe informatave tjera identifikuese personale deri në atë shkallë që është e mundur.</p> <p>3. Viktimat dhe dëshmitarët e trafikimit me njerëz kanë qasje në masat apo programet ekzistuese të mbrojtjes së dëshmitarëve në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Kodin e Procedurës Penale.</p> <p>4. Në rastet para gjykatës të cilat kanë të bëjnë me veprat penale sipas këtij ligji, gjykata mund t'ua lejojë viktimave të supozuara dhe dëshmitarëve të paraqesin dëshmitë e tyre në kamera ose përmes mjeteve të tjera elektronike ose speciale, siç shihet e përshtatshme nga gjykata.</p> <p>5. Një viktimë e trafikimit ose një dëshmitari jashtë Kosovës që mund të jetë në gjendje të ofrojë informata gjatë hetimit të rasteve që kanë të bëjnë me trafikimin me</p>	<p>traffickers and their collaborators.</p> <p>2. When it is necessary for ensuring physical safety of the victim or the witness, based on the request of the victim or the witness, or in consultation with him/her, the competent body undertakes all necessary measures for his/her displacement within or outside of Kosovo in line with the sub-chapter H of the law for the protection of personal data and limitation of disclosing his/her name, address and other personal identification information to the extent it is possible.</p> <p>3. Victims and witnesses of trafficking in human beings have access to existing witness protection programmes in line with Law on Witness Protection and the Criminal Procedure Code of Kosovo.</p> <p>4. In cases of appearing in front of court that deal with criminal actions according to this Law, the court might allow presumed victims or witnesses to present their evidence in cameras or through other electronic or special means, as deemed appropriate by the court.</p> <p>5. A victim of trafficking or a witness outside of Kosovo that might be able to provide information while investigating cases related to trafficking in human</p>	<p>njihovih pomagača.</p> <p>2. Kada je potrebno da se obezbedi fizička bezbednost žrtava ili svedoka, na zahtev žrtve ili svedoka ili na osnovu konsultacije, nadležni organ će preduzeti sve neophodne mere za njeno preseljenje unutar ili van Kosova u skladu sa podpoglavljem H zakona za zaštitu ličnih podataka i ograničavanje obelodanjivanja imena adrese i drugih ličnih informacija za identifikaciju u najvećoj mogućoj meri.</p> <p>3. Žrtve i svedoci trgovine ljudima imaju pristup merama ili postojećem programima zaštite svedoka u skladu sa zakonom za zastitu svedoka i Zakonom o krivičnoj Proceduri</p> <p>4. U sudskim postupcima koji se odnose na krivična dela iz ovog zakona, sud može da dozvoli da navodne žrtve i svedoci iznesu svoje dokaze pred kamerom ili putem drugih posebnih ili elektronskih sredstava, u zavisnosti šta se bude smatralo odgovarajućim od strane suda.</p> <p>5. Žrtva trgovine ljudima, ili svedok van Kosova kada može biti u stanju da pruži informacije tokom istrage slučajeva vezanih za trgovinu ljudima, može se</p>
---	--	--

<p>njerëz, mund t'i jepet autorizim i përkohshëm të mbetet në Kosovë dhe mbrojtje e duhur gjatë atyre periudhave dhe sipas kushteve të cilat konsiderohen të përshtatshme nga institucionet përgjegjëse.</p>	<p>beings might be given provisional authorization to remain in Kosovo and appropriate protection during these periods, and according to conditions that are considered appropriate by the institutions in charge.</p>	<p>odobriti privremeno ovlašćenje da ostane na Kosovu i odgovarajuća zaštita tokom tog perioda prema potrebama koje se smatraju odgovarajućim od strane odgovornih institucija.</p>
<p>6. Asgjë në këtë ligj nuk ua ndalon viktimave dhe përfaqësuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të tij/saj që të kërkojë kompensim të urdhëruar nga gjykata sipas procedurës civile dhe penale që garantohet me ligjet në fuqi.</p>	<p>6. Nothing in this law forbids the victims and their authorized representatives to claim compensation ordered by the court, according to the civil and legal procedure which is guaranteed by the laws in force.</p>	<p>6. Ništa u ovom zakonu ne zabranjuje žrtvi i predstavniku, odnosno njegovom/njenom ovlašćenom predstavniku da traži naknadu štete naloženo od strane suda u skladu sa civilnim i krivičnim postupcima što se garantuje važećim zakonima.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI – IV</p> <p style="text-align: center;">NDIHMA DHE MBROJTA E VIKTIMAVE TË TRAFIKUARA ME NJERËZ</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER - IV</p> <p style="text-align: center;">ASSISTANCE AND PROTECTION OF VICTIMS OF TRAFFICKING IN HUMAN</p>	<p style="text-align: center;">GLAVA - IV</p> <p style="text-align: center;">POMOĆ I ZAŠTITA ŽRTAVA TRGOVINE LJUDIMA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20</p> <p style="text-align: center;">Ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikuar me njerëz</p>	<p style="text-align: center;">Article 20</p> <p style="text-align: center;">Assistance and protection of victims of trafficking in human</p>	<p style="text-align: center;">Član 20</p> <p style="text-align: center;">Pomoć i zaštita žrtava trgovine ljudima</p>
<p>1. Viktimave të trafikimit me njerëz u jepet mbrojtje dhe ndihmë nga autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, në kuadër të kompetencave të tyre dhe në pajtim me këtë ligj dhe aktet tjera normative.</p>	<p>1. Victims of trafficking in human beings are given protection and assistance by the Authorities set in Article 6 of this Law, under their competencies and in line with this Law and other normative acts.</p>	<p>1. Žrtvama trgovine ljudima daje se zaštita i pomoć od strane Autoriteta što je označeno u članu 6 ovog zakona, u okviru svojih nadležnosti i u skladu sa ovim zakonom i drugim normativnim aktima.</p>
<p>2. Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, viktima e trafikimit, ka të drejtat themelore si në vijim:</p>	<p>2. In line with Criminal Procedure Code, a victim of trafficking has the fundamental rights as it follows:</p>	<p>2. U skladu sa Zakonom o krivičnom postupku, žrtva trgovine ljudima, ima sledeća osnovna prava:</p>

<p>2.1. të drejtën në informim mbi rrjedhën e procedurës si dhe për të gjitha të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi.</p> <p>2.2. të drejtën për tu trajtuar si palë në procedurë;</p> <p>2.3. të drejtën për qasje në shërbime ligjore pa pagesë;</p> <p>2.4. të drejtën për shërbime të përkthimit me shkrim dhe gojor, gjatë të gjitha fazave të procedurës, në gjuhë në të cilën ai/ajo e kupton;</p> <p>2.5. të drejtën në mbrojtje për viktimat dhe dëshmitarët, dhe në raste të caktuara edhe për familjet e tyre, të cilat ballafaqohen me kërcënime apo frikësime në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ;</p> <p>2.6. të drejtën për privatësi dhe konfidencialitet;</p> <p>2.7. të drejtën në parashtrimin e mjeteve juridike, përfshirë edhe ndihmën juridike në këtë çështje;</p> <p>2.8. të drejtën në strehim të përkohshëm;</p> <p>2.9. të drejtën në një periudhë reflektimi prej 30 deri në 90 ditësh me qëllim të rimëkëmbjes;</p>	<p>2.1. Right to information on the progress of criminal proceedings, as well as to all the rights pertained according to this Law and other legislation in force.</p> <p>2.2. Right to be treated as a party in procedure;</p> <p>2.3. Right of access to free of charge legal services;</p> <p>2.4. Right to written or oral translation services over all the phases of procedure, in an understandable language to him/her;</p> <p>2.5. Right to protect victims and witnesses, and in certain cases also for their families that are subjected to threats or intimidations in line with the Law on Witness Protection;</p> <p>2.6. Right to privacy and confidentiality;</p> <p>2.7. Right to enunciation of legal means, including legal assistance in this matter;</p> <p>2.8. Right to provisional refuge;</p> <p>2.9. Right to a reflection period of 30 to 90 days with purpose of recover.</p>	<p>2.1. Pravo na informacije o toku postupka i za sva prava koja mu pripadaju po ovom zakonu i drugim propisima na snazi;</p> <p>2.2. Pravo da se tretira kao stranka u postupku</p> <p>2.3. Pravo pristupa pravnim službama bez plaćanja;</p> <p>2.4. Pravo na pisane i usmene prevodilačke usluge, tokom svih faza postupka, na jezicima koji oni razumeju;</p> <p>2.5. Pravo na zaštiti žrtava i svedoka, i u određenim slučajevima i za njihove porodice, koje su suočene sa pretnjama ili zastrašivanjima imaju u skladu sa zakonom o zaštiti žrtava;</p> <p>2.6. Pravo na privatnost i poverljivost;</p> <p>2.7. Pravo podneska pravnih lekova, uključujući i pravnu pomoć po ovom pitanju;</p> <p>2.8. Pravo na privremeni smeštaj;</p> <p>2.9. Pravo na period refleksije (razmišljanja) od 30 do 90 dana u cilju oporavka.</p>
---	---	---

<p>2.10. të drejtën në ndihmë mjekësore, psikologjike, dhe shërbime për mirëqenie sociale, pagesë, siç mund të jetë e nevojshme për t'i përmbushur nevojat e tyre dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.11. të drejtën në dëmshpërblim dhe kompenzim;</p> <p>2.12. të drejtën e pjesëmarrjes në seancat mbi caktimin e dënimit apo informimin mbi vendimet lidhur me dënimin;</p> <p>2.13. të drejtën mbi informimin mbi lirimimin apo arratisjen e të pandehurit nga qendrat e paraburgimit.</p> <p>3. Të drejtat nga ky nen i ofrohen viktimave para, gjatë dhe, pas përfundimit të procedurave penale.</p> <p>4. Shërbimet e ndihmës të parapara me këtë nen, janë në dispozicion edhe të viktimave të cilat riatdhesohen nga një shtet tjetër në Republikën e Kosovës dhe për vartësit shoqëruar të viktimës.</p> <p>5. Ndihma dhe mbështetja e viktimave të trafikimit vihet në dispozicion porsa autoritetet kompetente të kenë bazë të arsyeshme për të besuar që personi mund t'iu ketë nënshtruar ndonjë veprë të paraparë të trafikimit me njerëz.</p>	<p>2.10. Right to medical, psychological assistance and social welfare services, payment as it might be necessary for meeting their needs and in line with legislation in force;</p> <p>2.11. Right to indemnity and compensation;</p> <p>2.12. Right to participation in sessions on determination of the sentence or information regarding the sentence;</p> <p>2.13. Right to information on release or escape of the defendant from detention centers.</p> <p>3. Rights from this Article are provided to victims prior, during and after completion of criminal procedures.</p> <p>4. Assistance services envisaged by this Article are also at the disposal of victims repatriated from another country in the Republic of Kosovo and accompanying dependants of the victim.</p> <p>5. Assistance and support to victims of trafficking is made available once the competent authorities have reasonable grounds for believing that the person might have been subjected to an envisaged action of trafficking in human</p>	<p>2.10. Pravo na medicinske, psihološke, socijalne zaštite i usluga koje mogu biti neophodne da se zadovolje njihove potrebe u skladu sa zakonom na snazi;</p> <p>2.11. Pravo na ime odštete i naknade;</p> <p>2.12. Pravo učešća u raspravi o određivanju kazne ili biti informisan u vezi odluke o kazni;</p> <p>2.13. Pravo na obaveštavanje o oslobađanju ili bekstvo optuženih iz pritvorskih centara.</p> <p>3. Prava iz ovog člana pružaju se žrtvama pre, za vreme i nakon okončanja krivičnog postupka.</p> <p>4. Usluge podrške koje pružaju ovim članom su na raspolaganju i žrtvama koje su repatrirane iz druge države u Republiku Kosova i patioca zavisnih žrtava,</p> <p>5. Pomoć i podrška za žrtve trgovine ljudima moraju biti dostupni čim nadležni organi steknu opravdane razloge da veruju da osoba može biti i da je bila izložena bilo kojim aktom predviđenog trgovinom ljudima.</p>
--	---	---

<p>6. Ndhurma dhe mbështetja e viktimës nuk kushtëzohen me gatishmërinë e viktimës për të bashkëpunuar gjatë hetimeve, ndjekjes apo gjykimit.</p> <p>7. Masat për ndihmë dhe mbështetje sigurohen në bazë të pëlqimit dhe informimit të duhur dhe duke marrë parasysh nevojat e veçanta të fëmijëve dhe viktimave të tjera të ndjeshme.</p> <p>8. Mbrojtësi i Viktimave ofron ndihmë dhe mbështetje ligjore për viktimën e trafikimit me njerëz, që nga kontaktet e para me organet kompetente. Mbrojtësi i viktimave merr pjesë në të gjitha fazat procedurale dhe përfaqëson viktimën e trafikimit në të gjitha seancat gjyqësore.</p> <p>9. Çdo herë kur organi kompetent, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare të cilat janë aktive në këtë fushë ka bazë të arsyeshme për të besuar se një person është viktimë e trafikimit me njerëz, atëherë personit të tillë i ofrohen të gjitha masat mbrojtëse dhe ndihma e përcaktuar më këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Rehabilitimi i viktimave të trafikimit</p> <p>Rehabilitimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet me qëllim të rehabilitimit dhe rikthimit të tyre në një jetë normale duke</p>	<p>beings.</p> <p>6. Assistance and support for the victim are not conditioned with the victim's willingness to cooperate during investigations, prosecutions or judgment.</p> <p>7. Assistance and support measures are provided based on appropriate accord and information, taking into account special needs of children and other vulnerable victims.</p> <p>8. Victims' Defender provides legal assistance and support to the victim of trafficking in human beings, since the very first contacts with the competent bodies. Victims' defender takes part in all procedural stages and represents the victim of trafficking in all trial sessions.</p> <p>9. Each time when the competent body, international organizations and non-governmental organizations that are active in this field has reasonable reasons to believe that a person is victim of trafficking in human beings, then one such person is provided with protective measures and assistance determined by this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Rehabilitation of victims of trafficking</p> <p>Rehabilitation of victims of trafficking in human beings is done with the purpose of their rehabilitation and return to normal</p>	<p>6. Pomoć i podrška žrtve ne zavisi od spremnosti žrtve da saraduje tokom istrage, krivičnog gonjenja ili suđenja.</p> <p>7. Mere obezbeđenja za pružanje pomoći i podrške zasnovane na saglasnosti i odgovarajuće informacije, a uzimajući u obzir posebne potrebe za decu i drugih osoba u ranjivom stanju.</p> <p>8. Odbrana žrtvama pruža pravnu pomoć i podršku za žrtve trgovine ljudima, od prvog kontakta sa nadležnim organima. Odbrana žrtava učestvuje u svim fazama postupka i predstavlja žrtvu trgovine ljudima u svim ročišta.</p> <p>9. Svaki put kada nadležni organi, međunarodne organizacije i nevladine organizacije koje su aktivne u ovoj oblasti poseduju opravdane razloge da se veruje da je osoba žrtva trgovine ljudima, onda se takvoj osobi obezbeđuju sve zaštitne mere i pomoć po ovom zakonu.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Rehabilitacija žrtava trgovine ljudima</p> <p>Rehabilitacija žrtava trgovine ljudima sprovodi se sa ciljem rehabilitacije i njihovog povratka u normalan život,</p>
--	---	---

<p>përfshirë dhënie e ndihmës mjekësore, psikologjike, juridike dhe materiale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Ri-integrimi i viktimave të trafikuar</p> <p>Ri-integrimi i viktimave të trafikimit me njerëz bëhet pas rehabilitimit me qëllim të përfshirjes së suksesshme shoqërore të viktimave të trafikimit me njerëz, në jetë normale dhe të lirë, duke ofruar qasje adekuate në shërbime edukuese, trajnime profesionale, mundësi për banim të përhershëm dhe të sigurt dhe pavarësi financiare përmes ofrimit të mundësive të ndryshme për (vetë) punësim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Sigurimi dhe mbështetja e qendrave dhe strehimoreve për strehim të përkohshme për viktimat e trafikimit</p> <p>1. Qeveria siguron mbështetjen e qendrave dhe strehimoreve të përkohshme dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz, me qëllim që qendrat apo strehimoret e specializuara të kenë mundësi për të ofruar kushte të akomodimit dhe higjienës personale, ushqimit, kujdesit urgjent dhe ndihmës ligjore, psikologjike dhe mjekësore, sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe ndihmës në ndërmjetësimin dhe kontaktimin e familjes dhe të afërmeve.</p> <p>2. Qendrat dhe strehimoret e përkohshme</p>	<p>life, including provision of medical, psychological, legal and material assistance.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Reintegration of victims of trafficking</p> <p>Reintegration of victims of trafficking in human beings is done after rehabilitation with the purpose of successful social inclusion of the victims of trafficking in human beings, into normal life and freedom, through provision of adequate access to educational services, vocational training, permanent and safe resident opportunities, as well as financial independence by providing different opportunities for (self)employment.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Security and support of Centers and shelters for temporary housing of victims of trafficking</p> <p>1. Government ensures support of Centers and provisional shelters as well as protection of victims of trafficking in human beings, with aim that the specialized centers or shelters to be able to provide conditions for accommodation, personal hygiene, food, urgent care and legal assistance, social, psychological and medical care, safety and protection, as well as assistance in mediation and in contacting family and relatives.</p> <p>2. Centers and provisional shelters might</p>	<p>uključujući i medicinsku, psihološku, pravnu i materijalnu pomoć.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Reintegracija žrtava trgovine ljudima</p> <p>Reintegracija žrtava trgovine ljudima se sprovodi nakon uspešne rehabilitacije sa ciljem socijalne uključenosti žrtava trgovine ljudima, u normalnom životu i slobodi, nudeći obrazovne usluge, stručno usavršavanje, pristup stalnom stanovanju i bezbednosti i finansijska nezavisnost pružajući različite mogućnosti za (samo) zapošljavanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Obezbeđivanje i podrška centara i prihvatilišta sa privremenim smeštajem za žrtve trgovine ljudima</p> <p>1. Vlada daje podršku centrima i privremenim skloništima za zaštitu žrtava trgovine ljudima, sa ciljem da će specijalizovani centri ili skloništa biti u stanju da ponude uslove smeštaja i lične higijene, ishrane, negu i pravnu, psihičku i medicinsku pomoć, bezbednost i odbranu, kao i u posredovanju i pomoći prilikom kontakta porodice i rođaka.</p> <p>2. Centri i privremena skloništa mogu se</p>
--	--	--

<p>mund të themelohen nga:</p> <p>2.1. Qeveria, sipas propozimit të Autoritetit Kombëtar;</p> <p>2.2. Autoritetit Kombëtar, sipas propozimit të autoriteteve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;</p> <p>2.3. Organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare, pas pëlqimit të Autoritetit Kombëtar;</p> <p>2.4. Autoritetet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji në bazë të marrëveshjes për aktivitete të përbashkëta dhe pas pëlqimit të Autoritetit Kombëtar.</p> <p>3. Shpenzimet e ndërlidhura me aktivitetet e përbashkëta të qendrave dhe strehimoreve do të mbulohen nga buxhetet e përbashkëta të tyre.</p> <p>4. Rregullimi i organizimit dhe veprimit të qendrave dhe strehimoreve miratohet nga themeluesit, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.</p> <p>5. Me qëllim të garantimit të sigurisë së qendrave dhe strehimoreve në të cilat akomodohen viktimat e trafikimit me njerëz, qendrat dhe strehimoret sipas kërkesës së tyre u sigurohet ndihmë dhe siguri nga policia.</p> <p>6. Qendrat i sigurojnë akomodim viktimave</p>	<p>be established by:</p> <p>2.1. Government upon the proposal of National Authority;</p> <p>2.2. National Authority according to the proposal of authorities set in Article 6 of this Law;</p> <p>2.3. Nongovernmental and international organizations upon approval of the National Authority;</p> <p>2.4. Authorities set in Article 6 of this Law, based on the agreement for joint activities and upon approval of the National Authority.</p> <p>3. Costs related to joint activities of the centers and shelters will be covered by their joint budgets.</p> <p>4. Arrangement of the organization and action of centers and shelters is approved by the founder, based on the respective legislation in force in Kosovo.</p> <p>5. With aim to guarantee safety of centers and shelters that accommodate victims of trafficking in human beings, centers and shelters, as per their requests, are provided assistance and safety by the police.</p> <p>6. Centres provide accommodation to</p>	<p>osnivati od strane;</p> <p>2.1. Vlade, na predlog Državnog organa;</p> <p>2.2. Državni organ, prema predlogu organa iz člana 6 ovog zakona;</p> <p>2.3. Međunarodnih i nevladinih organizacija nakon saglasnosti Nacionalnog autoriteta;</p> <p>2.4. Autoriteti iz člana 6 ovog zakona, na osnovu sporazuma o zajedničkim aktivnostima i nakon odobrenja Državnog organa;</p> <p>3. Troškovi u vezi sa zajedničkim aktivnostima centara i skloništa će biti pokriveni od strane njihovih kolektivnih budžeta.</p> <p>4. Uredba o organizaciji i delovanju centara i skloništa odobrenih od strane osnivača, a na osnovu relevantnih zakona koji važe na Kosovu.</p> <p>5. Da bi se garantovala sigurnost centara i skloništa koja primaju žrtve trgovine ljudima, skloništa i centri prema njihovom zahtevu dobijaju pomoć i bezbednost od strane policije.</p> <p>6. Centre za smeštaj žrtava trgovine</p>
---	--	--

<p>të trafikimit me njerëz në bazë të nevojave të vlerësuara për një periudhë tridhjetë (30) ditë deri në nëntëdhjete (90) ditë.</p> <p>7. Kohëzgjatja e akomodimit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni mund të vazhdohet:</p> <p>7.1. në bazë të rekomandimit të mjekut gjatë periudhës së trajtimit, por jo më gjatë se 6 muaj;</p> <p>7.2. në bazë të kërkesës së organeve të ndjekjes penale apo të gjykatës gjatë periudhës së procedurës penale, dhe kur jeta apo shëndeti i viktimës janë të kanosur nga rreziku real, kohëzgjatja e akomodimit mund të vazhdohet edhe pas përfundimit të procedurës penale për një periudhë e cila konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e viktimës, bazuar në kërkesën e prokurorit;</p> <p>7.3. në bazë të kërkesës së viktimës së trafikimit me njerëz, në të cilën jepet arsytimi, për një periudhë deri në 90 ditë.</p> <p>8. Gratë shtatzëna, të cilat janë viktima të trafikimit me njerëz, kanë të drejtë të akomodimit në qendër për një periudhë deri në një (1) vit, me mundësi vazhdimi.</p>	<p>victims of trafficking in human beings based on the assessed needs for period of thirty (30) up to ninety (90) days.</p> <p>7. Accommodation timeline set in paragraph 6 of this Article might be extended:</p> <p>7.1. based on doctor's recommendation during the treatment period, but not longer than 6 months;</p> <p>7.2. based on the request of legal prosecution bodies or the court's request during the criminal procedure period, and when the life and health of the victim is threatened by real danger, accommodation timeline might also be extended even after the completion of criminal procedure for a period that is considered necessary for protection of the victim, based on prosecutor's request;</p> <p>7.3. based on the request of the victim of trafficking in human beings, for a period of up to 90 days.</p> <p>8. Pregnant women, who are victims of trafficking, are entitled to accommodation the centre for a period of up to one (1) year, with possibility of extension.</p>	<p>ljudima obezbeđuju na osnovu procenjenih potreba na period od trideset (30) dana do devedeset (90) dana.</p> <p>7. Trajanje smeštaja iz stava 6. ovog člana može se produžiti:</p> <p>7.1. na preporuku lekara tokom perioda tretmana, ali ne duže od 6 meseci;</p> <p>7.2. na zahtev organa krivičnog gonjenja ili sudskog organa tokom krivičnog postupka, i kada je život ili zdravlje žrtve pod pretnjom realne opasnosti, trajanje smeštaja se može produžiti i posle završetka krivičnog postupka na period koji se smatra neophodan da zaštiti žrtvu, na zahtev tužioca;</p> <p>7.3. na zahtev žrtve trgovine ljudima, koja iznosi svoje razloge, na period do 90 dana.</p> <p>8. Trudnicama, koje su žrtve trgovine ljudima, imaju pravo na smeštaj u centru na period od jedne (1) godine, sa mogućnošću produžetka.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 24 Aftësimi profesional i viktimave të trafikimit</p> <p>Autoritetet bëjnë aftësimin profesional të viktimave të trafikimit me njerëz, sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke iu ofruar shërbime falas me prioritet në fushën e ndërmjetësimit në punësim, informacioneve, këshillimit profesional, orientimit profesional dhe trajnimeve profesionale, si dhe duke u siguruar të drejtën që të marrin pjesë në kursin e trajnimit profesional të financiar nga programi i papunësisë. Përfituesit e shërbimeve të përcaktuara në këtë paragraf janë viktimat e trafikuar të moshës mbi 16 vjet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Vocational training of victims of trafficking</p> <p>Authorities provide the vocational training for victims of trafficking in human beings, according to conditions set by the legislation in force, through provision of them free of charge services with priority on mediation in employment, information, professional counseling, professional orientation and professional training, as well as through providing them the right to take part in the professional training course funded by the unemployment programme. Beneficiaries of the determined services in this paragraph are victims of trafficking over 16 years of age.</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Stručna obuka za žrtve trgovine ljudima</p> <p>Autoriteti stručno osposobljavaju žrtve trgovine ljudima, u skladu sa uslovima propisanim zakonom na snazi, nude besplatne usluge sa prioritetom u oblasti posredovanja u zapošljavanju, informisanja, savetovanja, profesionalnog usmeravanja i stručnu obuku, kao i obezbeđivanje prava da učestvuju u profesionalnoj obuci finansiranoj od strane programa za zapošljavanje. Korisnici usluga navedenih u ovom stavu su žrtve trgovine ljudima, starije od 16 godina.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Informimi lidhur me procedurën për lëshimin e lejeve për qëndrim</p> <p>Nga momenti që autoritetet kompetente janë në dijeni se një person i huaj bie nën fushën e zbatimit të këtij ligji, ato e informojnë dhe e ndihmojnë personin në fjalë lidhur me mundësitë që i ofrohen në fushën e qëndrimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Information regarding the procedures for granting residence permits</p> <p>From the moment that competent authorities are aware that a foreign person falls under the scope of implementation of this Law, they inform and assist the person in question regarding the opportunities he/she is provided in the residence field.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Informacije o postupku za izdavanje dozvole boravka</p> <p>Od trenutka kada nadležni organi postaju svesni da strano lice podpada pod delokrug primene ovog zakona, oni će obavestiti zainteresovano lice o mogućnostima koje se pružaju u oblasti stanovanja.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 26 Periudha e reflektimit për viktimat dhe dëshmitarët e trafikimit me njerëz</p> <p>1. Nëse konsiderohet se një i huaj, qëndrimi i të cilit në Kosovë nuk është i rregullt, është viktimë apo dëshmitar i trafikimit me njerëz, autoritetet kompetente për zbatimin e Ligjit për të Huaj, i ofrojnë një periudhë reflektimi, gjatë së cilës personi në fjalë rimëkëmbet, i largohet influencës dhe cenimeve të keqbërësve dhe pa marrë parasysh nëse dëshiron apo jo të bashkëpunoj me autoritetet përkatëse.</p> <p>2. Kohëzgjatja, data e fillimit të periudhës së reflektimit dhe kushtet e përfundimit të kësaj periudhe rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për të huajt dhe dispozitave të këtij ligji. Respektimi i parimit të mos kthimit merret në konsideratë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Reflection period for victims and witnesses of trafficking in human</p> <p>1. If it considered that a foreigner, whose stay in Kosovo is not regular, is a victim or witness of trafficking in human beings, competent rule of law enforcement bodies on foreigners, offer him/her a reflection period, over which the person in question recovers, escapes from the influence and threats of perpetrators, irrespective to the fact if he/she wants to cooperate with respective authorities or not.</p> <p>2. Duration, start date of the reflection period and conditions for completion of this period are regulated according to provisions of the applicable legislation on foreigners and provisions of this Law. Respect of the non-refoulement principle is taken into consideration.</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Period refleksije za Źrtve trgovine ljudima i svedoka trgovine ljudima</p> <p>1. Ako se smatra da stranac, čije prebivalište na Kosovu nije regulisano, a on je Źrtva ili svedok trgovine ljudima, nadležni organi za primenu zakona za strance, obezbediće licu period refleksije, tokom kojeg se lice oporavlja, udaljava od uticaja zlonamernika i bez obzira na to da li Źele ili ne Źele da sarađuju sa relevantnim vlastima.</p> <p>2. Trajanje, datum početka perioda refleksije i uslova na kraju ovog perioda je regulisano odredbama zakona koje se primenjuju na strance i odredbama ovog zakona. Držeći se principa ne vraćanja koji se uzima u obzir.</p>
